

MODELI PËR DOKUMENTIN KONSULTATIV

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”, i ndryshuar”

Ministria e Brendshme fton qytetarë, organizata të shoqërisë civile, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”, i ndryshuar”.

Ministria e Brendshme mirëpret:

Komente të përgjithshme publike mbi përcaktimet e projektligjit, kryesisht mbi:

-Parashikimin për kodin unik të adresës, i cili identifikon në mënyrë unike vendndodhjen e çdo ndërtese apo trualli të lirë, në shkallë vendi.

- Përcaktimin e mënyrës së kodimit dhe strukturës së kodit unik të adresës me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Kontributet tuaja do të konsiderohen përgjatë procesit të përmirësimit të mëtejshëm të projektligjit.

Ministria e Brendshme do të përmbledhë të gjitha sugjerimet dhe komentet tuaja dhe do të japë sqarime për mënyrën se si ato janë reflektuar në projektakt, edhe në rast se mendimet nuk reflektohen në projektligj.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimi publik do të zgjasë të paktën 20 ditë pune sikurse kërkon ligji, nëpërmjet publikimit në RENJK, nga data 09 nëntor 2022 deri më 09 dhjetor 2022.

Si të përgjigjeni:

Mund të merrni pjesë në procesin e konsultimeve publike duke dërguar komente/kontribute për projektligjin:

- Duke plotësuar formularin online të Regjistrat Elektronik për projektaktit, në adresën elektronike: <http://www.konsultimipublik.gov.al>.

- Me email duke dërguar propozimet/sugjerimet tuaja në adresën e koordinatorit të konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme, Besmira Hoxha, në adresën: besmira.hoxha@mb.gov.al

Të dhënat e kontaktit të koordinatorit përkatës për konsultime publike dhe/ose të ndonjë personi tjetër të cilit i drejtohen pyetjet:

znj. Besmira Hoxha - Koordinatore e Konsultimit Publik për MB, e-mail besmira.hoxha@mb.gov.al

Datat dhe vendet e takimeve publike:

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”, i ndryshuar” propozohet në kuadër të nismës së ndërmarrë në Komitetin e Inovacionit, të mbajtur më datë 15.07.2022.

Projektligji është hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC) dhe Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Brendshme, përgjatë muajit shtator, tetor 2022, duke zhvilluar takimet në Ministrinë e Brendshme.

Projektligji është dërguar për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Sekretariatit Teknik të Komitetit të Inovacionit, në fillim të nëntorit 2022.

Sfondi i propozimit legjislativ

Projektakti, konkretisht projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”, i ndryshuar”, ka për qëllim shtimin e një elementi tjetër përbërës të adresës, krahas tetë elementeve aktualë, konkretisht elementi i nëntë i saj i cili përkon me një kod unik, që identifikon në mënyrë unike vendndodhjen e çdo ndërtese apo trualli të lirë, në shkallë vendi. Ky kod ka për synim lehtësimin e memorizimit të adresës për shtetasit në Republikën e Shqipërisë dhe krijimin e mundësisë për aksesimin e herëpashershëm të dokumentit unik shtetëror, pra Regjistrin Kombëtar të Adresave, që përmban elementët përbërës të adresës.

Gjithashtu, kodi unik nevojitet për të patur një vlerë të minimizuar të shkëmbimit të informacionit midis databazave kombëtare pa qenë e nevojshme që të kalojë i gjithë informacioni me tetë elementët e adresës, por të realizohet edhe përmes 1 (një) elementi të vetëm.

Propozimet

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”, i ndryshuar” propozohet në kuadër të nismës së ndërmarrë në Komitetin e Inovacionit, të mbajtur më datë 15.07.2022, për krijimin e një kodi unik si përfaqësues unik i adresës deri në rang ndërtese.

Në ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”, i ndryshuar, në nenin 2, përcaktohet si vijon:

1. “Adresa shërben për të identifikuar në mënyrë të saktë e unike vendndodhjen e çdo ndërtese, apartamenti apo trualli të lirë, në shkallë vendi, dhe **përbëhet nga këto elemente:**

a) emri i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në të cilën ndodhet ndërtesa;

b) emri i njësisë administrative, në të cilën ndodhet ndërtesa;

c) emri i qytetit ose fshatit ku ndodhet ndërtesa;

ç) emri i bulevardit/rrugës/rrugicës/sheshit ose parkut ku ka daljen ndërtesa dhe përcaktohet vetëm me njërin nga elementet e mësipërme. Emri formohet nga shkronja të alfabetit shqip dhe numra arabë, por jo vetëm me numra;

d) numri rendor i ndërtesës, bulevardit /rrugës/rrugicës/parkut ose sheshit. Ky numër rendor mund të jetë:

i) një numër natyror;

ii) dy numra natyrorë, të ndarë me shenjën e fraksionit (/);

dh) numri i hyrjes, që shërben për identifikimin e hyrjes në të njëjtën ndërtesë. Ky numër rendor mund të jetë:

i) një numër natyror;

ii) dy numra natyrorë, të ndarë me shenjën e fraksionit (/);

e) numri i apartamentit, që shërben për identifikimin e një banese/biznesi në një hyrje të ndërtesës. Ky numër rendor mund të jetë:

i) një numër natyror;

ii) dy numra natyrorë, të ndarë me shenjën e fraksionit (/);

ë) kodi postar, i miratuar.

2. Radha e vendosjes së elementeve të adresës përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike”.

Pra, me synim përmirësimin e elementeve të adresës, krahas 8 (tetë) elementeve përbërëse të adresës, do të shtohet edhe:

Elementi i nëntë i adresës, që do të përkojë me një kod unik dhe mënyra e krijimit e përshkrimi i detajuar teknik i tij do të përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave. Më konkretisht, projektligji ka parashikuar se mënyra e kodimit dhe struktura e kodit unik do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Gjithashtu, do të hiqet togfjalëshi “*bulevardit/rrugës/rrugicës/parkut ose sheshit*”, nga shkronja d), pika 1, e nenit 2 të ligjit aktual, pasi numër përmban vetëm ndërtesa, ndërsa bulevardi, rruga, rrugica, parku apo sheshi nuk identifikohen me numër.

Pyetjet

Jeni të ftuar të jepni komentet dhe kontributet tuaja për të gjitha aspektet e projekt-ligjit të propozuar.

- Si i vlerësoni përcaktimet në projektligj, kryesisht mbi:

Parashikimin e një elementi të nëntë të adresës, që do të përkojë me një kod unik?

- A jeni dakord me parashikimet e përcaktuara në projektligj, kryesisht për:

Mënyrën e krijimit e përshkrimit të detajuar teknik të tij që do të përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave? Më konkretisht, mbi parashikimin e mënyrës së kodimit dhe strukturës së kodit unik që do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave?